



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Primiçenë/Prodate Received/Delivered	26.11.2018	vit god year	8
Organizimi Organizacija Org./Unit	SKPMSHCK	Kolicina Quantity	111
Proti Prot. No.	7158/2018		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 305 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë.
2. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë;
- Menaxherit të Personelit në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit

Page 1 / 1



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Received	26 - 11	8	viti / year
Pranuesi / Receiver		201	
Organ / Njësia / Org./Unit	Dr. Prot. / Dr. Prot. / Prot. No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPMSHCK	7158/2018		1/18



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORT I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË

AGJENCINË PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

PËR VITIN

2017

Prishtinë, 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	03
Funksioni i mbikëqyrjes.....	03
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	03
Fushat e mbikëqyrjes.....	04
Raporti për mbikëqyrjen në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë.....	05
Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve.....	09
Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit.....	12
Procedurat disiplinore.....	13
Procedurat e ankesave.....	14
Procedurat e vlerësimit.....	14
Procedurat e pushimeve.....	15
Procedurat e transferimit.....	15
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me aftësi të kufizuara.....	15
Pezullimi, ndërprerja dhe përfundimi i marrëdhënies së punës.....	16
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	16
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	17
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	17
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	17
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	17
Shënimet/komentet për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	18

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI I KËSHILLIT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes, Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil nga institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar „Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton „Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim të vitit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë, duke u bazuar në „Pyetësin për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil” kemi kryer monitorimin duke zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit për shërbimin civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli gjatë zbatimit të mandatit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të institucioneve, të cilët janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil.

Në këtë kuadër, si pjesë e mbikëqyrjes janë përfshirë fushat:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me aftësi të kufizuara;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË AGJENCINË PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË PËR VITIN 2017

Kolegji gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, për të vlerësuar drejtë, në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës me datë 27.02.2018, në prezencë të U.D së menagjerës së personelit, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Vendimi i datës 05.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën Drejtor i Drejtorisë për IT dhe regjistra në AZHB;
- Vendimi i datës 05.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën Drejtor i drejtorisë për Kontroll në AZHB;
- Vendimi i datës 05.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën Drejtor në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave në AZHB;
- Vendimi i datës 05.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën drejtorit në Drejtorinë për pagesa direkte në AZHB;
- Vendimi i datës 05.12/2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën Drejtor në drejtorinë e administratës në AZHB;
- Vendimi i datës 25.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën Drejtor i drejtorisë për Kontroll në AZHB;
- Vendimi i datës 25.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën drejtorit në Drejtorinë për pagesa direkte në AZHB;
- Vendimi i datës 25.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën Drejtor i Drejtorisë për IT dhe regjistra në AZHB;
- Vendimi i datës 25.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën Drejtor në drejtorinë e administratës në AZHB;
- Vendimi i datës 25.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën Drejtor në drejtorinë për Miratim të AZHB;
- Vendimi i datës 06.09.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën Drejtor në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave në AZHB;
- Vendimi i datës 01.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën menagjere e personelit në divizionin e Administratës së Përgjithshme në AZHB;
- Vendimi i datës 07.03.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës shef i Divizionit për Miratim të projekteve;
- Vendimi i datës 08.12.2017 për caktimin në punët dhe detyrat e punës Zyrtar i Autorizimit të pagesave në Drejtorinë e autorizimit të pagesave në AZHB;
- Vendimi i datës 27.06.2017 për caktimin në punët dhe detyrat e punës Zyrtar i lartë i logjistikës në Divizionin e Administratës së Përgjithshme;
- Vendimi i datës 07.04.2017 për caktimin në punët dhe detyrat e punës Zyrtar i lartë i miratimit të projekteve të Zhvillimit rural në Divizionin e projekteve;
- Lista e pagave për muajin nëntor të vitit 2017;
- Vendimi i datës 01.11.2017 për caktimin në punët dhe detyrat e punës Zyrtares të autorizimit të pagesave në Drejtorinë e autorizimit të pagesave;
- Vendimi i datës 09.08.2017 për formimin e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave;
- Vendimi i datës 26.05.2017 për formimin e komisionit disiplinor;

- Opinioni i departamentit të Buxhetit i datës 27.03.2017;
- Opinion i Departamentit të Buxhetit i datës 15.09.2017;
- Opinion i Departamentit të Buxhetit i datës 04.10.2017;
- Formulari i planit individual të personelit i datës 17.11.2016;
- Rregulloren Nr. 01/2012 për detyrat dhe përgjegjësit, kompetencat dhe strukturën organizative të AZHB-së e datës 09.01.2013;
- Vendimi i datës 24.10.2017 për shfuqizim të Vendimit nr. 07/04/015/2017 i datës 24.02.2017 për pezullimin parandalues për shefin e Divizionit për miratimin e projekteve të zhvillimit rural në AZHB;
- Vendimi i datës 24.02.2017 për pezullimin parandalues për shefin e Divizionit për miratimin e projekteve të zhvillimit rural në AZHB;
- Forma MAP-SHCK-05 për procedurën e rekrutimit për pozitën zyrtar certifikues;
- Forma MAP-SHCK-09 për procedurën e rekrutimit për pozitën zyrtar certifikues;
- Forma MAP-SHCK-11 për procedurën e rekrutimit për pozitën zyrtar certifikues;
- Regjistri i datës 24.05.2017 i aplikacioneve të pranura për pozitën zyrtar certifikues;
- Kopja e konkursit e datës 10.05.2017;
- Vendimi i datës 25.05.2017 për formimin e komisionit përzgjedhës;
- Testi me shkrim për pozitën zyrtar certifikues i datës 02.06.2017;
- Vendimi i datës 27.10.2017 për emërimin e kandidatit të përzgjedhur për pozitën zyrtar certifikues;
- Marrëveshja e datës 21.04.2015 për transferimin e nëpunësit civil;
- Akt Emërimi i datës 07.05.2015 i zyrtarit të lart për miratimin e projekteve;
- Formulari i datës 12.02.2018 i vlerësimit të rezultateve në punës për nëpunësin në pozitën inspektor terreni në Prishtinë;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017 për pozitën inspektor teknik në AZHB-ZMT-Ferizaj;
- Vendimi me nr. 363/2 i datës 08.02.2017 për caktimin e përkohëshëm në punët dhe detyrat e punës zyrtar për IT në AZHB nga data 12.01.2017 deri me 12.07.2017 (marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 08.02.2017);
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 08.02.2017 për pozitën zyrtar për autorizimin e pagesave në AZHB nga data 12.01.2017 deri me 12.07.2017;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 29.08.2017 për pozitën zyrtar për autorizimin e pagesave në AZHB nga data 01.08.2017 deri me 31.01.2018;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 29.08.2017 për pozitën zyrtar për IT në AZHB nga data 01.08.2017 deri me 31.01.2018;
- Vendimi me nr. 411/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtare e arkivave në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 411/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtare e teknologjisë informative në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 409/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtar i arkivave në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 403/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën inspektor teknik në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);

- Vendimi me nr. 400/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtare e pagesave direkte në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 439/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën inspektor teknik në Gjakovë nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 398/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtare për autorizim të pagesave në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 397/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtar për pagesa direkte në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr.383/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtar për pagesa direkte në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr.380/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtare e arkivave në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 379/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën e inspektorit teknik në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 277/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën e zyrtarit për pagesa direkte në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 276/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën e zyrtarit për pagesa direkte në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 275/24 i datës 21.12.2017 për caktimin në punët dhe detyrat e zyrtarit për pagesa direkte në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 273/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën e zyrtarit për miratim të PZHR-së në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 272/24 i datës 21.12.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën e zyrtarit për miratim të PZHR-së në AZHB nga data 01.12.2017 deri me 31.12.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.12.2017);
- Vendimi me nr. 413/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën inspektor teknik në AZHB-ZMT Ferizaj nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr. 411/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtare e arkivës në AZHB nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr. 410/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën Zyrtare e teknologjisë informative në AZHB nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017-(Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr. 409/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën recepcionist në AZHB nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017-(Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);

- Vendimi me nr. 406/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtar i pagesave direkte në AZHB- nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017;
- Vendimi me nr. 403/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën inspektor teknik në AZHB-ZMT Pejë nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017;
- Vendimi me nr. 401/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtare e pagesave direkte në AZHB-nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017
- Vendimi me nr. 400/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtare e administratës së përgjithshme në AZHB- nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017;
- Vendimi me nr. 399/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën inspektor teknik në AZHB nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr. 398/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtare për autorizim te pagesave në AZHB- nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017;
- Vendimi me nr. 397/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtar i pagesave direkte në AZHB- nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017;
- Vendimi me nr. 396/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtar i pagesave direkte në AZHB- nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017;
- Vendimi me nr. 383/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën Zyrtar i pagesave direkte në AZHB-ZMT nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017-(Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr.381/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën asistente Administrative në AZHB- nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr. 380/12 i datës 28.06.2017 për caktimin në punët dhe detyrat inspektor teknik në AZHB-ZMT Ferizaj nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr. 379/12 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën inspektor teknik në AZHB-ZR Ferizaj nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr. 277/14 ii datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtare e pagesave direkte në AZHB- nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr. 276/14 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtar i pagesave direkte në AZHB- nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr. 275/14 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtar për pagesa direkte në AZHB- nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi me nr. 272/14 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën Zyrtar për miratimin e projekteve në AZHB nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);

- Vendimi me nr. 273/14 i datës 28.06.2017 për caktimin përkohësisht në pozitën zyrtar për miratim të projekteve në AZHB nga data 01.06.2017 deri me 30.06.2017- (Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 28.06.2017);
- Vendimi i komisionit disiplinor i datës 03.04.2017;
- Vendimi i komisionit disiplinor i datës 03.04.2017;
- Vendimi i komisionit disiplinor i datës 03.04.2017;
- Vendimi i komisionit disiplinor i datës 03.04.2017;;
- Vendimi i komisionit disiplinor i datës 03.04.2017;
- Vendimi i komisionit disiplinor i datës 03.04.2017;
- Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave i datës 14.07.2017;
- Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave i datës 12.12.2017;
- Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave i datës 31.10.2017;
- Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave i datës 04.10.2017;
- Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave i datës 29.08.2017;
- Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave i datës 29.08.2017;
- Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave i datës 29.08.2017;
- Vendimi për pezullim parandalues i datës 24.02.2017;
- Vendimi i datës 19.05.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
- Vendimi i datës 10.07.2017 për kompensimin e një page mujore të menjëhershme;
- Vendimi i datës 16.08.2017 për transferim të përhershëm të nëpunësit civil;
- Marrëveshja e datës 16.08.2017 për transferim të përhershëm;
- Vendimi i datës 15.08.2017 për transferim të përhershëm.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil e vlerëson bashkëpunimin e treguar, përgatitjen e dokumenteve dhe informatat e ofruara nga udhëheqësja e personelit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë gjatë realizimit të vizitës me datë 27.02.2018.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në pyetësonin për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar të gjeturat në vijim të raportit, si dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë me datë 27.02.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren nr. 01/2012 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të datës 09.01.2013. Sipas deklarimit nga menaxherja e personelit dhe në bazë të provave të shqyrtuara, konstatohet se Akt Emërimit e nëpunësve civil janë në pajtim me këtë rregullore. Sipas deklarimit të zyrtares së personelit, në këtë institucion janë të punësuar 66 nëpunës civil, ndërsa në vitin 2017 kanë pasur 11 pozita të lira.

Gjatë vizitës monitoruese, Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e nëpunësve civil për pozitën „Inspektor terreni”; „zyrtar i lartë për miratimin e PZHR”; dhe „Inspektor”, dhe në bazë të vlerësimeve nuk ka gjetur shkelje pasi që dosjet e personelit janë të ruajtura dhe të kompletuara në pajtim me dispozitat e nenit 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Në bazë të informatave të ofruara, është konstatuar që Agjencia për zhvillimin e Bujqësisë, ka pasur të caktuar 20 ushtrues të detyrës.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve për ushtruesit e detyrës, gjegjësisht vendimeve për caktimin e ushtruesit të detyrës, ka konstatuar të gjeturat në vijim:

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me nr. 07/4-5347, në pozitën „Drejtor në drejtorinë për IT dhe Regjistra” në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita shef i Divizionit IT dhe regjistra, nga data 25.08.2017, ndërsa me datë 05.12.2017 caktohet serish „Drejtor në drejtorinë për IT dhe Regjistra” dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me nr. 07/4-5345 në pozitën „Drejtor në Drejtorinë për Kontroll” është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita e Shef i divizionit të kontrollit, nga data 25.08.2017, ndërsa me datë 05.12.2017 me Vendimin me nr.07/4-7943 ricaktohet në pozitën „Drejtor në Drejtorinë për Kontroll” dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me nr. 07/4-5684 në pozitën „Drejtor në Drejtorinë për autorizim të pagesave” është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita e Shef i divizionit në Administratën e Përgjithshme, nga data 06.09.2017, ndërsa me datë 05.12.2017 me Vendimin me nr.07/4-7944 ricaktohet në pozitën „Drejtor në Drejtorinë për autorizim të pagesave” dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me nr. 07/4-5346 në pozitën „Drejtor në Drejtorinë për Pagesa Direkte” është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita e Shef i divizionit të pagesave direkte, nga data 25.08.2017, ndërsa me datë 05.12.2017 me Vendimin me nr.07/4-7945 ricaktohet në pozitën „Drejtor në Drejtorinë për Pagesa Direkte” dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me nr. 07/4-5348 në pozitën „Drejtor i Administratës së Përgjithshme” është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita e Menagjer i personelit në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, nga data 25.08.2017, ndërsa me datë 05.12.2017 me Vendimin me nr.07/4-7946 ricaktohet në pozitën „Drejtor në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme” dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me nr. 07/4-629 në pozitën „shef i divizionit për miratimin e projekteve” është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita zyrtar i lartë në Divizionin për Miratimin e Projekteve, nga data 07.03.2017, ndërsa me datë 25.08.2017 me Vendimin me nr.07/4-5349 ricaktohet në pozitën „Drejtor në Drejtorinë për Miratimin e projekteve” dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me nr. 07/4-4494 në pozitën „Menagjere e personelit” është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita „Zyrtare e lartë e personelit” nga data 01.08.2017 dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Me këto veprime Agjencia për Zhvillimine Bujqësisë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafit 4 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për sa i përket afatit kohor për caktimin e ushtruesit të detyrës.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit nr.07/4-8139 në pozitën „Zyrtar të autorizimit të Pagesave” është caktuar nëpunësi civil nga pozita e zyrtarit të lartë të Prokurimit, nga data 08.12.2017 deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit nr.07/4-9140 në pozitën „zyrtar i autorizimit të pagesave” është caktuar nëpunësi civil nga pozita e zyrtarit zotues, nga data 08.12.2017 deri në një vendim tjetër.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit nr.07/4-1118 në pozitën „Zyrtar i lartë i Miratimit të Projekteve ” është caktuar nëpunësi civil nga pozita e zyrtarit të lartë të kontrollit, nga data 07.04.2017 deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit nr.07/4-1117 në pozitën „Zyrtar i lartë i Miratimit të projekteve ” është caktuar nëpunësi civil nga pozita e zyrtarit të lartë të IT nga data 07.04.2017 deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit nr.07/4-6801 në pozitën „Zyrtar të autorizimit të Pagesave” është caktuar nëpunësi civil nga pozita e zyrtarit certifikues nga data 27.10.2017 deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit nr.07/4-3046 në pozitën „Zyrtar i lartë i logjistikës” është caktuar nëpunësi civil nga pozita inspektor teknik, nga data 27.06.2017 deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Me këtë veprime Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafit 4 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe dispozitat e nenit 37 paragrafit 4 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, për sa i përket afatit kohor për ushtruesin e detyrës si dhe për nëpunësin zëvendësues.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe menagjerin e personelit, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura për eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe për zbatimin e dispozitave ligjore të nenit 30 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe dispozitat e nenit 36 dhe 37 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, për pozitat e lartcekura si dhe për çdo rast të caktimit të ushtruesit të detyrës apo të zëvendësimit të nëpunësit civil.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë nuk e ka pasur të përgatitur planin për procedurat e rekrutimit. Kolegji ka konstatuar ky institucion ka pasur shtatëmbëdhjetë (17) pozita të lira. Në këtë institucion janë zhvilluar shtatë (7) procedura të rekrutimit, ndërsa katër (4) procedura kanë qenë në zhvillim në momentin e monitorimit.

Kolegji ka analizuar procedurën e rekrutimit për pozitën „Zyrtare certifikuese”, dhe pas vlerësimit të dosjes, ka konstatuar që testi me shkrim nuk është përpiluar në pajtim me nenin 36 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

E GJETURA 1. Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, pas analizimit të procedurës së rekrutimit për pozitën „Zyrtare certifikuese” dhe pas vlerësimit të dosjes, ka konstatuar që testi me shkrim nuk është përpiluar në pajtim, me nenin 36 paragrafin 1 nënparagrafi 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil sepse në pjesën e tretë janë parashtruar njëzetë (20) pyetje të gjitha në formë eseje, ndërsa në nenin 36, nënparagrafin 1.3 të Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil është përcaktuar që kandidatëve duhet tu parashtrohen 15 deri në 23 pyetje të cilat janë 50% me përgjigje të shumëfishta dhe 50% në formë eseje.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe menagjerin e personelit si dhe KPSHC-të përkatëse, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura për eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe për zbatimin e dispozitave ligjore të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil e posaqërisht me rastin e përgatitjes së testit me shkrim sipas kriterëve të nenit 36 të Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për mbikëqyrje në bazë të dokumenteve të shqyrtuara ka konstatuar që Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, gjatë vitit 2017 në periudha të ndryshme kohore, ka pasur të angazhuar gjithësejt 43 nëpunës me marrëveshje për shërbime të veçanta.

E GJETURA 2: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, për vitin 2017 ka pasur të angazhuar gjithësejt 43 nëpunës me marrëveshje për shërbime të veçanta, prej të cilëve 43 pozitat për të cilat janë angazhuar këta nëpunës, kanë qenë pozita të nëpunësve civilë. Kolegji si mostër ka marr marrëveshjet për shërbime të veçanta për të gjitha pozitat e lartcekura.

Kolegji ka konstatuar që në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarëve: „pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës”.

Në kuptim të kësaj dispozite, pozitat e nëpunësve civil të karrierës apo të jo karrierës, nuk mund të plotësohen me nëpunës me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për zhvillimin e Bujqësisë dhe Menaxherin e Personelit që të ndërmarrin veprimet për eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe që për pozitat e nëpunësve civil, të mos angazhojnë nëpunës në bazë të kontratave për shërbime të veçanta por që plotësimi i vendeve të lira të punës të caktuara për nëpunës civil të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

E GJETURA 3: Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të dosjeve për marrëveshje për shërbime të veçanta dhe në bazë të informatave të pranuara, ka konstatuar që gjatë vitit 2017, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, nuk ka zbatuar dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil me rastin e angazhimit të nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta për 43 pozitat për të cilat janë angazhuar këta nëpunës civilë.

Në lidhje me marrëveshjet e lartëcekura, Kolegji i Këshillit nuk ka gjetur asnjë dëshmi për zhvillimin e procedurës së thjeshtësuar të rekrutimit për angazhimin e nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta, edhe pse ka pasur raste kur i njëjti nëpunës është angazhuar në të njëjtën pozitë me disa marrëveshje për shërbime të veçanta.

Me këtë veprime Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që përcakton angazhimin me „Marrëveshje për shërbime të veçanta” me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

REKOMANDIMI 3:

Rekomandojmë kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, që të ndërmarrin veprimet e menjëhershme për eliminimin e shkeljeve të evidentuara dhe ndërprerjen e angazhimit të nëpunësve me „Marrëveshje për shërbime të veçanta” në kundërshtim me procedurën e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore përkatëse.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në bazë të Vendimit me Nr. 07/4-2326 të datës 26.05.2017 ka të themeluar Komisionin Disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar por në arsyetim është thënë që anëtari i dytë i komisionit disiplinor nga pika 1 e këtij Vendimi është anëtar i rastit- njohës i fushës. Në këtë fushë kemi konstatuar këtë të gjetur.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 07/4-2326 të datës 26.05.2017 ka të themeluar Komisionin disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar por në arsyetim është thënë që anëtari i dytë është anëtar i rastit- njohës i fushës. Kolegji ka konstatuar që Komisioni disiplinor duhet të jetë i përbërë nga tre (3) anëtar dhe duhet të kenë mandat dy (2) vjeçar ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes pasi që Komisioni disiplinor duhet të jetë i përbërë nga tre (3) anëtar dhe duhet të kenë mandat dy (2) vjeçar ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në bazë të Vendimit me Nr. 07/4-4837 të datës 09.08.2017 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili është i themeluar me tre (3) anëtar por në arsyetim është thënë që anëtari i dytë i komisionit për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nga pika 1 e këtij Vendimi do të emrohet me vendim të veçantë nga rasti në rast për të garantuar barazi etnike, gjinore dhe të përforcoj balancën, objektivitetin dhe ekspertizën e komisionit. Në këtë fushë kemi konstatuar këtë të gjetur.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 07/4-4837 të datës 09.08.2017 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili është i themeluar me tre (3) anëtar por në arsyetim është thënë që anëtari i dytë do të emrohet me vendim të veçantë nga rasti në rast. Kolegji ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave duhet të jetë i përbërë nga tre (3) anëtar dhe duhet të kenë mandat dy (2) vjeçar ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes pasi që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave duhet të jetë i përbërë nga tre (3) anëtar dhe duhet të kenë mandat dy (2) vjeçar ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, për dosjet e kontrolluara vlerësimi i rezultateve në punë është bërë jashtë afatit të përcaktuar ligjor.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për pozitën Inspektor terreni i datës 15.02.2018, vlerësimi është bërë jashtë afatit të përcaktuar ligjor.

Kolegji konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me dispozitat e nenit 3 paragrafit 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Udhëheqësin e Personelit që të ndërmarrin veprimet ligjore për eliminimin e shkeljeve dhe që për të gjithë nëpunësit civil të bëhet vlerësimi i punës nga udhëheqësit e drejtpërdrejtë të tyre ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me dispozitat e nenit 3 paragrafit 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, evidenca e pushimeve të nëpunësve civilë mbahet në kopje fizike dhe elektronike.

Gjithësejt 14 nëpunës civil kanë realizuar pushimin mjekësor, dhe në bazë të dokumenteve në dosje të nëpunësve civilë, është konstatuar që nëpunësit civil kanë sjell dëshmitë mjekësore në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Në bazë të vlerësimit të dosjeve dhe vendimeve përkatëse, është konstatuar që për pushimet e nëpunësve civilë, janë zbatuar dispozitat e Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë dhe në këtë fushë nuk është evidentuar asnjë shkelje.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, gjatë vitit 2017 ka pasur dy (2) transferime të përhershme.

Në bazë të shqyrtimit të dosjeve, konstatohet që janë respektuar procedurat e parapara me Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ka të punësuar 55 nëpunës civil, prej tyre 55 janë shqiptar, prej tyre 11 janë femra ndërsa 44 janë meshkuj.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar edhe numrin e të punësuarve në aspektin gjinor dhe ka konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 55 nëpunësve civil të punësuar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, 44 nëpunës janë meshkuj, ndërsa vetëm 11 nëpunëse të punësuar janë femra, që nënkupton se nuk ka numër të të punësuarve ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, që të ndërmerr veprimet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ka të punësuar 55 nëpunës civil, dhe nuk ka të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar që „Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor”.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për respektimin e dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, ka pasur dy (2) nëpunës civil me pezullim parandalues me 50% të pagës. Prej këtyre nëpunësve, njërit nëpunës i ka përfunduar pezullimi parandalues.

Ndërprerje të marrëdhënies së punës ka pasur në shtatë (7) raste, prej të cilave në një (1) rast për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, ndërsa në gjashtë (6) raste, kemi pasur ndërprerje të marrëdhënies për shkak të masës disiplinore.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në bazë të informatave të pranuar nga zyrtarët e personelit, ka konstatuar se në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, nuk ka pasur asnjë nëpunës civil i cili e ka mbajtur pozitën e nëpunësit civil dhe poashtu në të njëjtën kohë e ka ushtruar detyrën e funksionarit publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të informatave të pranuar nga zyrtarët e personelit, ka konstatuar se në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, ka pasur dy (2) nëpunës civil, ndaj të cilëve është zhvilluar procedurë penale, dhe të cilët janë pezulluar me 50% të pagës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, është përgatitur plani i trajnimeve për vitin 2017, por që në këtë institucion nuk është mbajtur evidencë për numrin e nëpunësve civilë që kanë ndjekur trajnimet gjatë vitit 2017.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë nuk është mbajtur evidencë për numrin e nëpunësve civilë që kanë ndjekur trajnimet gjatë vitit 2017.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe udhëheqësen e personelit, që për përgatitjen e planit të trajnimeve të nëpunësve civilë, të respektojnë afatet dhe procedurat e përcaktuara me dispozitat e nenit 16 të Rregullores Nr. 19/2012 për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil si dhe të mbajnë evidencën për vijimin e trajnimeve nga nëpunësit civilë.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, evidenca e vijimit në punë mbahet në formë fizike. Sipas deklarimit nga menaxherja e personelit, pagat e nëpunësve civil janë në pajtim me Akt Emërimet. Poashtu është konstatuar që nëpunësve civil i është bërë kompensimi i përcaktuar me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Këshilli nuk ka realizuar vizitë monitoruese për vitin paraprak në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Lidhur me Vendimet e Këshillit, është konstatuar që Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, i ka zbatuar vendimet e Këshillit të pranuar në vitin 2017.

15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË AGJENCINË PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË


Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për vitin 2017, ka arritur që të konstatoj 10 (dhjetë) të gjetura dhe ka dhënë 10 (dhjetë) rekomandime lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, që të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresojnë dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojnë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Lulzim ALIAJ
Kryetar i Kolegjit



Zyle GOJNOVCI
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Raporti i dërgohet:

- Kryeshefit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Menaxherit të Personelit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Arkivit të KPMSHCK.